



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725, [URL:http://www.umib.net](http://www.umib.net), Mail:rektorati@umib.net

RAPORT I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE
PËR PERIUDHËN JANAR/MARS - 2020

Prill/2020

P Ë R M B A T J A

1. Hyrja.....	3
2. Analiza e Buxhetit.....	5
3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike	8
4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike...9	
4.1 Paga dhe mëditje	9
4.2 Mallra dhe shërbime.....	11
4.3 Shpenzime komunale.....	14
4.4 Subvencione dhe transfere.....	14
4.5 Investime kapitale.....	15
5. Të hyrat vetanake.....	16

1. HYRJE

Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, neni 45 pika 45.2 lidhur me raportet tremujore buxhetore, Statutin e Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës neni 28 pika 1.9 dhe 1.10 mbi detyrat dhe përgjegjësitë e rektorit, neni 180 lidhur me procedurat buxhetore, rektori i Universitetit të Mitrovicës paraqet për aprovim raportin mbi planifikimin dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-mars të vitit fiskal 2020.

Raporti përmban një analizë përmbledhëse të performancës së aktiviteteve të planifikuara të cilat ndërlidhen me objektivat e planifikuara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2020/2022, vendimeve nga niveli qendror(MF,MASHT), rekomandimeve të Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit.

Periudha raportuese për Universitetin e Mitrovicës, karakterizohet si sfiduese me faktin se janë planifikuar ose do të jenë në finalizim shumë aktivitete të cilat ndërlidhen me mjete financiare dhe kufijtë e përcaktuar buxhetor për të gjitha kategoritë ekonomike. Rezultatet e planifikuara në masë të madhe ishin të kushtëzuara nga mos aprovimi me kohë i Ligjit mbi Buxhetin për vitin fiskal 2020 e cila ndërlidhet edhe me alokimin e mjeteve për të periudhën raportuese.

Raporti, përmes pasqyrave financiare, pasqyron se në ç'mënyrë institucioni i Universitetit të Mitrovicës bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore dhe vendimin mbi ndryshimin e buxhetit për vitin 2020, administroi: burimet financiare dhe shpenzimet

Pasqyrat financiare për periudhën raportuese janë të bazuara në dokumentet:

1. Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë-pasqyrimi i pasqyrave financiare.
2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2020-2022.
3. Ligji mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.
4. Statuti i përkohshëm për UMIB.
5. Buxheti për vitin 2020 për UMIB
6. Planin e rrjedhës së parasë të bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2020


Pasqyrat financiare janë të harmonizuara me të dhënat e sistemuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës(SIMFK).

Buxheti për Universitetin e Mitrovicës i bazuar në Ligjin për Buxhetin të Republikës së Kosovës nr.07/L-001

Buxheti për UMIB i aprovuar në mars/2020 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.07/L-001 është 4.211.245.00 euro që në krahasim me buxhetin të vitit 2019 është më i ulët për 577.724.00 euro ose me indeks prej 12.063% .

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2020
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.879.706.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	366.339.00
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00
4.	SUBVENCIONE	100.000.00
5.	INVESTIME KAPITALE	650.000.00
6.	GJITHSEJ	4.211.245.00



Buxheti i strukturuar sipas kategorive ekonomike dhe burimeve të financimit

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2020	Burimet e financimit	
			Buxheti i Kosovës	Të hyrat vetanake
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.879.706.00	2.765.045.00	114.661.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	366.339.00	366.339.00	
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00	215.200.00	
4.	SUBVENCIONE	100.000.00	100.000.00	
5.	INVESTIME KAPITALE	650.000.00	650.000.00	
6.	GJITHSEJ	4.211.245.00	4.096.584.00	114.661.00


Paga dhe mëditje- për vitin fiskal 2020 masa buxhetore e planifikuar për përmbushjen e obligimeve për paga është 2.879.706.00 euro që është për 122.276.00 euro më e lartë se paga për vitin fiskal 2019. Indeksi i rritjes është për 4.43% kurse pjesëmarrja e buxhetit për paga dhe mëditje në strukturë është 68.38% të buxhetit të aprovuar.

Mallra dhe shërbime - Masa buxhetore për këtë kategori është 366.339.00 dhe është më e ulët për 500.000.00 euro ose me indeks të zvogëlimit për 57.71% në krahasim me buxhetin të vitit 2019.

Shpenzime Komunale- shpenzimet komunale janë 215.200.00 dhe janë në nivelin e vitit fiskal 2019.

Subvencionet- mjetet e planifikuara janë në shumë prej 100.000.00 euro dhe janë në nivelin e vitit 2019.

Investime kapitale- Investimet kapitale për këtë vit fiskal janë planifikuar me shumë prej 650.000.00 dhe janë më të ulëta për 200.000.00 euro ose me indeks prej 23.53% në krahasim me vitin 2019.



2. ANALIZA E BUXHETIT

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike i bazuar në kufijtë final të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për Universitetin e Mitrovicës pasqyron mundësinë e realizimit të aktiviteteve të cilat ndërlidhen me fushëveprimin e Universiteteve publike.

Buxheti për UMIB-in i aprovuar në Mars/2020 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.07/L-001 është 4.211.245.00 euro që në krahasim me buxhetin e vitit 2019 është më i ulët për 577.724.00 euro ose me indeks prej 12.063%.

Për periudhën raportuese (janar-mars) janë alokuar mjete në shumë prej 1.201.853.68 euro ose 28.54% të buxhetit të aprovuar. Alokimi i mjeteve është bërë bazuar në Kompetencat e MF për alokimin e mjeteve konform nenit 24 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Realizmi i buxhetit për të njëjtën periudhë është me indeks prej 55.82% (670.908.11) bazuar në alokimin e mjeteve ose me indeks prej 15.93% në krahasim me buxhetin e aprovuar. Mjetet e angazhuara për këtë periudhë janë në shumë prej 680.097.43 euro ose 56.59% të mjeteve të alokuara.

Periudha janar/mars karakterizohet për racionalizim të shpenzimeve duke përcaktuar edhe prioritetet që ndërlidhen me realizimin e kërkesave të njësive akademike. Vëmendje e posaçme ju kushtua racionalizimit të shpenzimeve me qëllim që mjetet e kursyera të orientohen në organizimin e funksionalizimit të Kampusit universitar si dhe furnizimit me mjete/pajisje që do të jenë në proces të mirëmbajtjes së procesit të funksionimit të laboratorëve të njësive akademike.

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit dhe mbikëqyrjes së realizimit është përqendruar që kërkesat të jenë të harmonizuara me planifikimin e shpenzimeve të bazuar në planin e rrjedhës së parasë së gatshme për të njëjtën periudhë.

Periudha janar/mars për shkak të specifikave në aspektin buxhetor dhe financiar karakterizohet mjaft sfiduese për faktin:

1. Vonesa në aprovimin e buxhetit,
2. ndryshimeve dhe alokimit me vonesë të mjeteve për periudhën raportuese,
3. ndërhyrja arbitrare e Thesarit në mjetet e planifikuara për investime kapitale.

Aprovimi me vonesë i buxhetit dhe alokimit, ndikoi që në kategoritë ekonomike: mallra dhe shërbime dhe investime kapitale mos të arrihen objektivat e planifikuara. Për periudhën raportuese në kategorinë mallra dhe shërbime është planifikuar që të bëhet funksionalizimi dhe pajisja e bibliotekës me inventar dhe teknologji informative si dhe rregullimi i hapësirës ku do të vendoset muzeu i kristaleve. Projekti kap shumë prej 124.000.00 euro.


Investimet kapitale kanë po të njëjtat vështirësi të realizimit edhe pse është bërë alokimi vetëm i 50% të mjeteve të planifikuara. Nga mjetet e alokuara në mënyrë arbitrare, vendim i Thesarit

është bërë ekzekutimi i pagesës në shumë prek 78.3664.65 euro konform vendimit të Gjykatës për kompensimin e pagave për personelin administrativ(ankesa)

Vështirësitë e lartë shënuara përkundër angazhimeve ndikuan që indeksi i realizimit të jetë vetëm 55.82 % në krahasim me mjetet e alokuara. Indeksi i realizimit është më i lartë për 25.31% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019(30.51%).

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar planifikimi, alokimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën raportuese janar/mars 2020.

Buxheti i planifikuar i bazuar në Ligjin mbi buxhetin për 2020	Alokimi Janar/Mars/2020	Mjetet e shpenzuara Janar/Mars 2020	Indeksi i realizimit në raport me Ligjin e aprovuar mbi buxhetin 2020	Indeksi i realizimit në raport me alokimin e mjeteve
1	2	3	$4=3/1*100$	$5=3/2*100$
4.211.245.00	1.201.853.68	670.908.11	13.42	55.82



Periudha prill/dhjetor/2020 do të jetë sfiduese me faktin se për këtë periudhë janë të planifikuara shume aktivitete të cilat ndërlidhen me fushëveprimin e Universitetit. Aktivitetet e planifikuara në funksionalizim të hapësirave që do të jenë në shërbim të studentëve, pajisja me inventar, pajisja e laboratorëve me mjete themelore, organizimi i konferencave me karakter ndërkombëtar, mirëmbajtja si dhe organizimi i fillimit të ri akademik në objekte të reja universitare janë prioritetet të përcaktuar nga menaxhmenti. Gjendje e krijuar për luftimin e COVID 2019 do të ndikoj në rrjedhën e realizimit të objektivave të planifikuara. Sfiduese sidomos do të jetë realizimi i investimeve kapitale dhe i paralajmërimi për zvogëlimin e pagave për sektorin publik.

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit përmes pasqyrave financiare në mënyrë analitike do të pasqyrojnë si është bërë menaxhimi i parasë publike për periudhën raportuese, duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikim, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuar nëpër kategori ekonomike.


3. Pasqyra e realizimit të buxhetit e strukturuar sipas kategorive ekonomike

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit përmes pasqyrave financiare pasqyron: si është bërë menaxhimi i parasë publike duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikim, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuara nëpër kategori ekonomike.

Për periudhën raportuese (janar-mars) janë alokuar mjete në shumë prej 1.201.853.68 euro ose 15.93 % të buxhetit të aprovuar. Realizimi i buxhetit është me indeks prej 55.82 % (670.908.11 euro) bazuar në alokimin e mjeteve.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar realizimi i buxhetit i krahasuar me burime, alokime, zotime, realizim dhe indeks të realizimit

Kategoritë ekonomike	Buxheti i planifikuar bazuar në Ligjin mbi buxhetin 2020	Alokimi Janar/Mars	Mjetet e shpenzuara Janar/Mars	Zotimet/ obligimet e pa shlyera	Shpenzimet e planifikuara	Mjetet e pashfrytëzuarra	Mjetet e angazhuara në %	Shpenzimi i buxhetit në %
	1	2	3	4	5=3+4	6=2-5	7=5/2*100	8=3/2*100
Paga & Mëditje	2.879.706.00	536.084.13	536.084.13		536.084.13		100	100
Mallra&Shërbime	366.339.00	183.169.50	33.930.96	9.189.32	43.120.28	140.049.22	23.54	18.52
Shpenzime komunale	215.200.00	107.600.00	22.228.32		22.238.32	85.371.68	20.66	20.65
Subvencione	100.000.00	50.000.00				50.000.00		
Kapitalet	650.000.00	325.000.00	78.664.65		78.664.32	246.335.35	24.20	24.20
Total	4.211.245.00	1.201.853.68	670.908.11	9.189.32	680.097.43	521.756.25	56.61	55.82



Pagat dhe mëditjet - janë alokuar 536.084.13 euro për përmbushjen e obligimeve për paga për personelit akademik të rregullt, të angazhuar dhe personelin administrativ. Për periudhën raportuese janë realizuar 536.084.13 euro ose me indeks të realizimit prej 100% përkatësisht janë shpenzuar mjete me indeks prej 18.61% të mjeteve të planifikuara (2.879.706.00 euro) sipas buxhetit të aprovuar.

Mallrat dhe shërbimet janë alokuar 183.169.50 euro ose me indeks prej 50% të mjeteve të planifikuara sipas buxhetit të aprovuar. Mjetet e alokuara janë realizuar në shumë prej 33.930.96 euro ose me indeks prej 18.52 % në krahasim me mjetet e alokuara.

Shpenzimet komunale janë alokuar 107.600.00 dhe janë realizuar 22.228.32 euro ose me indeks prej 78.92% në krahasim me mjetet e alokuara.

Subvencionet dhe transferet –janë alokuar 50.000.0 euro dhe mjetet janë zotuar në muajin prill në shumë prej 30.000.00 euro për të përmbushur obligimet për pjesën e dyte për bursa për student(gjatë muajit prill do të realizohet pjesa e dytë e bursës).

Investimet kapitale -sipas planit të rrjedhës së parasë janë alokuar 325.000.00 mjetet për investime kapitale, në mënyrë arbitrare janë ekzekutuar 78.664.65 ose 24.20% të shumës së alokuar.

4. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuara nëpër kategori ekonomike.

4.1 PAGA DHE MËDITJE

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje është 2.879.706.00 euro i planifikuar për përmbushjen e obligimeve ndaj 196 punëtorëve (128 personel akademik dhe 67 personel administrativ) dhe 4 anëtar të KD të UMIB-it . Bazuar në strukturën organizative, numrin e planifikuar dhe rregulloren mbi të ardhurat personale të aprovuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, masa e planifikuar buxhetore mbulon të gjitha pozitat e planifikuara sipas strukturës organizative për personel akademik, administrativ dhe anëtar të KD.

Universiteti i Mitrovicës ka hartuar planin e personelit për vitin 2020 për administratë dhe personel akademik i cili është i bazuar në strukturën organizative të aprovuar, numrin aktual dhe numrin e vendeve të lira. Plani nënkupton edhe disponueshmërinë e mjeteve për të mbuluar obligimet ndaj personelit aktual dhe plotësimin e vendeve të lira.

Bazuar në numri e lejuar dhe buxhetin e aprovuar për paga dhe mëditje planifikohej që gjatë vitit fiskal të mbulohen të gjitha vendet e lira për personel akademik dhe administrativ.Në fillim të vitit me vendim të MAP është lejuar vazhdimi i procesit të rekrutimit të personelit të administrativ të pezulluar me konkursin e vitit 2019.

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar realizimi i pagave për periudhën janar/mars në raport me alokimin e mjeteve për të njëjtën periudhë.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Paga e planifikuar bazuar në Ligjin mbi ndarjen buxhetore për vitin 2020	Alokimi e mjeteve për paga për periudhën Janar-Mars/2020	Pagat e realizuara për periudhën Janar-Mars/2020	Indeksi i realizimit në raport me mjetet e alokuara për Janar-Mars/2020
		2	3	4	5=4/3*100
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.879.706.00	536.084.18	536.084.18	100


Sipas planit të rrjedhës së parasë për periudhën raportuese është planifikuar (sipas rregullave të MF 1/12 e pagës totale) shuma prej 719.926.50 euro, janë alokuar 536.084.18 euro kurse janë shpenzuar 536.084.18 euro. Mjetet janë realizuar me indeks prej 100% në krahasim me mjetet e alokuara. Bazuar në metodologjinë e aplikuar nga MF,UMIB-i për këtë periudhë ka suficit për 183.842.32 euro. Mbetja do të shpërndahet varësisht nga nevoja për të plotësuar numri e pozitive të lira për vitin fiskal 2020.

Nr	Planifikimi I pagave për periudhën janar/mars të bazuar në planin e rrjedhës së parasë për vitin 2020	Alokimi I mjeteve për periudhën janar/mars	Realizimi I pagave për periudhën janar/ mars	Mbetja e buxhetit për periudhën janar/mars
	1	2	3	4=1-3
1	719.926.50	536.084.18	536.084.18	118.842.32

Pasqyra e realizimit të pagave të planifikuara, të strukturuar sipas realizimit mujor për UMIB

n r	UMIB	Personeli administrativ	shuma	Personel Akademik	shuma	Personel akademik i angazhuar	shuma	Anëtar i Keshillit Drejtues	Shuma	totali	
1	JANAR	45	27.979.00	104	150.335.93	41		4	798.00	194	179.112.90
2	SHKURT	44	28.664.43	104	148.148.50	38	911.44	4	903.00	190	178.627.33
3	MARS	44	29.128.80	104	147.957.10	39	838.84	4	420.00	191	178.343.94
4	Gjithsej		85.771.43		446.441.50		1.750.28		2.121.0		536.084.21

Nga pasqyra e lartë shënuar vërehen se shuma prej 446.441.50 euro është shpërndarë për personelin akademik ose 83.27% të shumës së shpërndarë(536.084.21),për personelin akademik të angazhuar janë shpërndarë 1.750.28 euro ose 0.32% dhe për personelin administrative të strukturuar në administratën qendrore(rektorat) dhe njësitë akademike shuma prej 85.771.43 euro ose 15.99% dhe shuma prej 2.121.00 euro ose 0.39 të shumës së shpërndarë për periudhën raportuese.



4.2 MALLRA DHE SHËRBIME

Për periudhën janar/mars bazuar në planin e rrjedhës së parasë janë alokuar mjete në shumë prej 183.169.50 euro, janë realizuar 33.930.96 euro dhe mjete të zotuar (angazhuara) në shumë prej 43.120.28 euro. Për periudhën raportuese janë angazhuar 43.120.28 ose me indeks të angazhimit prej 23.54 % më krahasim me mjetet e alokuara.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi i mjeteve sipas buxhetit	Alokimi i mjeteve-janar/mars	Mjetet e shpenzuara-janar/mars	Mjetet e zotuar-janar/mars	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4	5=3/2*100
1.	MALLRA DHE SHËRBIME	366.339.00	183.169.50	33.930.36	43.120.28	18.52

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar shpenzimet të strukturuar nëpër kode ekonomike duke bërë krahasime me mjetet e planifikuara sipas ndarjes buxhetore, alokimin e mjeteve dhe realizimin për periudhën raportuese.

UNIVERSITETI I MITROVICËS (Granti qeveritar)				
KATEGORIA EKONOMIKE	BUXHETI PËR VITIN 2020	ALOKIMI I MJETEVE JANAR-MARS/2020	MJETET E SHPENZUARA JANAR - MARS/2020	MJETET E SHPENZUARA NË %
	1	2	3	4 = 3:2*100
Mallrat dhe shërbimet	366,339.00	183,169.50	33,930.96	19
Shpenzimet e udhëtimit	12,000.00	3,000.00	2,209.15	74

Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit	12,000.00	3,000.00	2,209.15	74
Shërbimet e telekomunikimit	21,500.00	7,406.76	394.86	5
Shpenzimet per Internet	1,800.00	624.91		
Shpenzime e telefonisë mobile	18,000.00	5,400.00	394.86	7
Shenzimet postare	500.00	181.85		-
Shpenzimet për përdorim të kabllit optik	1,200.00	1,200.00		
Shpenzimet për shërbimet	73,739.00	70,698.09	6,071.46	9
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	7,500.00	4,459.09		-
Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	1,000.00	1,000.00		
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	1,000.00	1,000.00		
Sherbime shtypje-jo marketing	28,000.00	28,000.00		-
Sherbime tjera kontraktuese	31,739.00	31,739.00	5,361.46	17
Sherbimet teknike	2,500.00	2,500.00		
Shpenzimet për anëtarësim	2,000.00	2,000.00	710.00	36
Blerja e mobilieve dhe pajisjeve më pak se 1000 Euro	42,000.00	26,866.99	-	-
Kompjuterë	12,000.00	12,000.00		-
Pajisje tjera	30,000.00	14,866.99		-
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	15,500.00	7,500.00	-	-
Furnizime për zyrë	10,000.00	4,000.00		-
Furnizim me dokumente bllanko	1,000.00			
Furnizim me ushqim dhe pije(- jo dreka zyrtare)	2,000.00	1,000.00		-
Furnizime pastrimi	500.00	500.00		
Furnizim me veshmbathje	1,000.00	1,000.00		
Akomodimi	1,000.00	1,000.00		-
Derivatet dhe lëndët djegëse	4,000.00	1,415.86	306.48	22
Karburant për vetura	4,000.00	1,415.86	306.48	22
Llogarite e avansit	6,000.00	6,000.00	1,000.00	17
Avans per para te imeta(p.cash)	2,000.00	2,000.00	1,000.00	50
Avans per udhetime zyrtare	4,000.00	4,000.00		

Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	63,600.00	17,000.00	10,177.80	60
Regjistrimi i automjeteve	3,100.00	1,500.00		
Taksat komunale e regjistrimit të automjeteve	500.00	500.00		-
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	60,000.00	15,000.00	10,177.80	68
Mirëmbajtja	105,000.00	31,600.00	10,001.08	32
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,500.00	1,000.00		-
Mirëmbajtja e ndërtesave	60,000.00	20,000.00	10,001.08	50
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	40,000.00	9,600.00		-
Mirëmbajtja e mobilieve dhe pajisjeve	2,500.00	1,000.00		-
Shpenzimet e marketingut	12,000.00	7,000.00	-	-
Reklamat dhe konkurset	5,000.00	2,000.00		-
Botimet e publikimeve	2,000.00	1,000.00		-
Shpenzimet për informim publik	5,000.00	4,000.00		-
Shpenzimet e përfaqësimit	10,000.00	4,681.80	3,485.30	74
Drekat zyrtare	10,000.00	4,681.80	3,485.30	74
Shpenzime për vendime të gjykatave	1,000.00	-	284.83	-
Shpenzime për vendime të gjykatave	1,000.00		284.83	-

Funksionalizimi i kampusit të ri universitar ishte prioritet i menaxhmentit dhe K.D. të cilat në masë të madhe ishin të realizuara në vitin fiskal 2019. Akordimi i buxhetit shtesë prej 500.000.00 u mundësua që të krijohen standarde të reja për ofrim të shërbimeve për student duke krijuar ambiente dhe teknologji informative të kohës.

Masa buxhetore e planifikuar për kategori ekonomike nuk do të mjaftonte për realizimin e objektivave për funksionalizim të kampusit. Menaxhmenti për këtë qëllim do të krijojë program të ri për racionalizim të shpenzimeve duke përcaktuar qartë prioritetet.

Në indeks të realizimit prej 18.52 % ndikoi edhe vonesa në aprovimin dhe alokimin e mjeteve buxhetore. Alokimi jo me kohë e mjeteve buxhetore pamundësoi edhe realizimin e projektit për finalizimin e pajisjes së bibliotekës me inventar, kompjuter, muzeut të kristaleve dhe hapësirave tjera në shumë prej 124.000.00. Mjetet për këtë projekt janë zotuar dhe në muajin prill ka filluar realizimi i projektit. Me zotim të mjeteve prej 124.000.00 euro indeksi i angazhimit të mjeteve për kategori në krahasim me mjetet e alokuara kishte me qenë 91.23%.

4.3 SHPENZIMET KOMUNALE

Për këtë kategori janë alokuar mjete në shumë prej 107.600.00 euro duke shpenzuar 22.228.32 euro ose 20.65% të shumës së alokuar. Plani i rrjedhës së parasë për shpenzime komunale është i bazuar në shpenzimet e realizuar për periudhën tetor/nëntor të vitit 2019. Shuma e alokuar është me indeks prej 50% të mjeteve të planifikuara sipas buxhetit të aprovuar (215.200.00).

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
		1	2	3	$4=3/2*100$
1	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00	107.600.00	22.228.32	20.65

Në tabelën e poshtëshënuar, në mënyrë analitike, janë pasqyruar shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

Nr	Përshkrimi	Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2018	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
1	2	3	4	5	$6=5/4*100$
1.	E.elektrike	93,506.32	35,506.00	6,186.88	17
2.	H. e ujit	14,499.00	2,400.00	995.98	41
3.	Mbeturina	9,172.66	2,499.33	928.00	37
4.	PTK	95,522.02	66,570.67	14,117.46	21
5.	Ngrohja qendrore	2,500.00	624.00	6,186.88	17
6	Totali	215,200.00	107,600.00	22,228.32	20.65

4.4 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Planifikimi i mjeteve buxhetore për kategorinë e subvencioneve në shumë prej 100.000.00 euro është bërë për t'i stimuluar studentët për lirim nga pagesa, të bazuara sipas rregulloreve për shërbimet e ofruara, si dhe stimulimin e studentëve të dalluar duke i shpërblyer me bursa të ndara nga UMIB-i.

Për periudhën raportuese janë alokuar mjete në shumë prej 50.000.00 euro, mjetet janë planifikuar për të përmbush obligimet për pjesën e dytë për bursa për student në shumë prej 29.520.00 euro. Mjete janë alokuar në fund të muajit mars kurse zyra për buxhet dhe financa ka bërë zotimin e mjeteve në prill.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Zotimi i mjeteve	Realizimi për janar/mars/2020
		1	2	3	4
1	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	100.000.00	50.000.00		

4.5 INVESTIMET KAPITALE

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për këtë vit fiskal, për investime kapitale janë planifikuar mjete në shumë prej 650.000.00 euro që në krahasim me vitin 2019 masa buxhetore është zvogëluar për 200.000.00 ose me indeks prej 23.53% . Mjete e planifikuara në shumë prej 650.000.00 euro është ndarë për pajisjen e laboratorëve të njësive akademike, pajisje me teknologji informative e cila do të jetë në funksion të funksionimit të laboratorëve dhe ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës së objekteve të ndërtuara.

Nr.	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Shuma
1.	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	<i>Furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike</i>	150.000.00
2.	Fakulteti i Gjeoshkencave	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave</i>	150.000.00
3.	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore</i>	245.000.00
4.	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për teknologji informative</i>	50.000.00
5.	Rektorat/njësi akademike	<i>Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi</i>	30.000.00
	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për mirëmbajtjen e gjelbërimit</i>	25.000.00
6.	Gjithsej /2020		650.000.00

Ministria e Financave përmes Thesarit në mënyrë arbitrare ndërhyri në buxhetin e planifikuar për investime kapitale duke bërë zvogëlimin për 78.664.65 dhe atë për projektet: furnizimi me pajisje për laboratorët e FTU 60.00.00 euro dhe FGJ 18.664.65. Ndërhyrja është bërë me qëllim të përmbushjes së obligimeve sipas vendimit të Gjykatës për personelin administrativ (ankesa).

Pasqyrë e strukturës së investimeve kapitale pas ndërhyrjes

Nr.	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Shuma
1.	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	<i>Furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike</i>	150.000.00
2.	Fakulteti i Gjeoshkencave	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave</i>	131.335.35
3.	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore</i>	185.000.00
4.	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për teknologji informative</i>	50.000.00
5.	Rektorat/njësi akademike	<i>Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi</i>	30.000.00
	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për mirëmbajtjen e gjelbërimit</i>	25.000.00
6.	Gjithsej /2020		571.335.35

Për periudhën raportuese mjetet e planifikuara janë alokuar në shumë prej 325.000.00 ,janë realizuar mjete në shumë prej 78.664.65 euro ose me indeks prej 24.20 %.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar gjendja e realizimit të investimeve të planifikuara kapitale.

n r	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Buxheti i planifikuar me ndryshime	Alokimi i mjeteve	realizimi	Indeksi i realiz.
1	FIMK	<i>Furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike</i>	150.000.00	75.000.00		
2	FGJ	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave</i>	131.335.35	75.000.00	18.664.65	24.88
3	FTU	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore</i>	185.000.00	122.500.00	60.000.00	48
4	Rektorat	<i>Furnizimi me pajisje për teknologji informative</i>	50.000.00	25.000.00		
5	Rektorat	<i>Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi</i>	30.000.00	15.000.00		
6	Rektorat	<i>Furnizimi me pajisje për mirëmbajtjen e gjelbërimit</i>	25.000.00	12.500.00		
7	Gjithsej		571.335.35	325.000.00	78.664.65	24.20

Pasqyrë e planifikimit, alokimit, zotimit dhe realizimit të mjeteve për periudhën janar/mars/2020

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Realizimi për janar/mars/2020	indeksi
1.		1	2	3	4=3/2*100
	Investime kapitale	650.000.00	325.000.00	78.664.65	24.20

5. TË HYRAT VETANAKE

Bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e dala nga Ligji mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës dhe udhëzimit administrativ të MASHT-it nr. 17/2014 për përcaktim të lartësisë së tarifave për ofrim të shërbimeve për studentë, për periudhën raportuese janë inkasuar 34.294.50 euro (niveli Bachelor dhe Master) dhe janë të dedikuara vetëm për mbulimin e obligimeve për kategorinë paga dhe mëditje.

Indeksi i realizimit të grumbullimit të hyrave nga shërbimet e ofruara është 29.90% në krahasim me mjetet e planifikuara prej 114.661.00 euro.

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar të hyrat vetanake të planifikuara, inkasimi, alokimi, dhe shpenzimet.

	Planifikimi sipas Ligjit mbi Buxhetin për 2020	ALOKIMI	Inkasimi i THV për janar/mars	Indeksi i realizimit
	1	2	3	4=3:1*100
1	114.661.00		34.294..50	29.90

Realizimi i inkasimit të të hyrave vetanake në krahasim më të njëjtën periudhë të vitit fiskal 2019 është më i ulët për 10.740.05 ose me indeks prej 23.85%. Nga të hyrat e realizuar është planifikuar që të bëhet shpenzimi për kategorinë ekonomike paga dhe medijtje.

Të Hyrat e realizuara të strukturuar sipas njësive akademike

rNr	Përshkrimi i të hyrave-pagesave	F A K U L T E T I / N J Ě S I A A K A D E M I K E						TOTALI
		FIMK	FTU	FGJ	EDUKIM	JURIDIK	EKONOMIK	
1	Për certifikatë të notave dhe diplomës	155.00	77.50	67.50	102.50	30.00	72.50	505.00
2	Për diplomë dhe mbrojtje të diplomës	45.00	60.00	25	55.00	15.00	55.00	255.00
3.	Për mbrojtje të diplomës/master			200.00				200.00
4.	Për paraqitje të provimeve/master	70.00	355.00	180.00				605.00
5.	Për provim pranues për regjistrim për studime master							
6.	Për shërbime tjera				30		50.00	80.00
7.	Për provim në rast të transferit	3.50	4.50		11.50	5.00		24.50
8.	Për semestër për studentë të rregullt	8.000.00	2.825.00	1.325.00	9.050.00	4.550.00	1.325.00	27.075.00
9.	Për semestër për studime master		4.200.00	1.350.00				5.555.00
10.	Gjithsej	8.273.50	7.522.00	3.147.50	9.249.00	4.600.00	1.502.50	34.294.50